



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.971/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit të përmbartimit NP “E.B.” - Graçanicë, të cilin me autorizim e përfaqëson av.J. I. nga Prishtina, kundër debitorit të përmbartimit “Arbëria Turist” sh.p.k. - Suharekë, të cilin me autorizim e përfaqëson av.T. H. nga Prishtina, në procedurën përmbartimore sipas dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - dega në Suharekë, PP.nr.151/20, të datës 02.02.2021, me datën **07.12.2021**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit të përmbartimit NP “E.B.” - Graçanicë , ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - dega në Suharekë, PP.nr.151/20, i datës 02.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - dega në Suharekë, me aktvendimin e atakuar, PP.nr.151/20, të datës 02.02.2021, e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhërin përmbartimor të përmbartuesit privat P.nr.192/20, të datës 08.10.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditorja për shkak të *konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të LPP-së*, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor, apo lënda ti kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e palës kreditore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbartimit NP "E.B." - Graçanicë, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit të përmbartimit A.T." sh.p.k. - Suharekë, ndërsa përmbartuesi privat me urdhërin P.nr.192/20, të datës 08.10.2020, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbartimor - Faturës, Nr.09/19, të datës 02.04.2019, për pagesën e borxhit në shumë prej 5,000.00€, të paraparë më gjerësisht si në dokumentin përmbartimor.

Kundër urdhërit për përmbartim P.nr.192/20, të datës 08.10.2020, debitori ka ushtruar prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin tani të atakuar PP.nr.151/20, të datës 02.02.2021, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhërin për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat, e ka shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar sepse dokumenti në bazë të cilit është inicuar procedura nuk është i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se nuk përmban kohën e përmbushje së detyrimit. Tutje ka shtuar se në këtë çështje ka vlerësuar edhe shkresën-deklaratën e kreditorit me të cilën ka deklaruar se fatura është bërë e krkueshme me datën 01.05.2019, mirëpo e ka vlerësuar të pavlefshme sepse nuk është vepruar konform nenti 30 të LPP-së, pasi që është dashur ti dërgohet debitorit duke i caktuar edhe afatin për përmbushjen e detyrimit, andaj në rastin konkret ka vlerësuar se urdhëri përmbartimor është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore sipas LPP-së. Për mënyrën e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 29, 43, 71 par.1 dhe nenit 73 par.3 të LPP-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 13 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe

sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditores Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përbarimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përbarimor është i papërshtatshëm për përbarime edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përbarimor - Fatura, Nr.09/19, të datës 02.04.2019, i njëjti në dispozitiv nuk e *përmban kohën e përmbushjes së detyrimit*, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qendrojnë pretendimet prapësuese të debitores në lidhje me papërshtatshmërinë e përbarueshmërisë së dokumentit përbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale. Poashtu gjykata ka vlerësuar edhe shkresën e dhënë nga ana e kreditorit lidhur me arritshmërinë e përmbushjes së kërkesës, ku është cekur se fatuara është bërë e kërkueshme nga data 01.05.2019, mirëpo sipas vlerësimit të Apelit e njëjta nuk është përpiluar konform dispozitave ligjore të nenit 30 të LPP-së, pasi që ashtu si ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë për tu konsideruar e rregullt është dashur që ti dërgohet debitorit dhe ti caktohet një afat kohor për përmbushjen e detyrimit, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë. Eventualisht pala kreditore mund të parashtrijë propozim të ri në bazë të dokumentit përbarimor i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përbarimor.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.971/21, datë 07.12.2021

**Gjyqtari
Arsim Hamzaj**